



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

---

Numri i lëndës: 2023:096415

Datë: 06.09.2023

Numri i dokumentit: 04651118

CP.nr.264/2023

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes kryetarit Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Abdyli, në lëndën përbarimore të kreditorit F. L. nga fshati Sllakovc i Epërm, komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arton Ibrahimimi avokat nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, ushqimit dhe udhëtimit, sipas dokumentit përbarimor, aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.763/2020 të datës 18.06.2021 dhe aktgjykimit të gjykatës së Apelit Ac.nr.6537/21 të datës 20.02.2023, jashtë seance gjyqësore, në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), më datë 06.09.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** Urdhërohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Thesari në Prishtinë që mjetet monetare nga xhirollogaria e debitorit Komuna e Gjilanit, që për kompensimin e shpërblimit jubilar, ushqimit dhe rrugëtimin shumë prej 2,701.44 euro, për shpenzimet e procedurës kontestimore shuma prej 270 euro, shpenzimeve të procedurës përbarimore, shumë prej 196 euro, apo shuma e përgjithshme prej **3,167.44 euro** t'i bartet të autorizuarit të kreditorit, av.Arton Ibrahimimi, në llogarinë rrjedhëse me nr.të xhirollogarisë: ..... në TeB Bank, pasi që aktvendimi mbi caktimin e përbarimit CP.nr.264/23 i datës 17.07.2023 është bërë i ekzekutueshëm nga data 31.08.2023 në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

**II.** Pika I e këtij dispozitivi e ka efektin e aktvendimit mbi caktimin e përbarimit me të cilin është caktuar ekzekutimi i kredisë në të holla të debitorit dhe kalimi i saj për arkëtim në dobi të kreditorit në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

**III.** Aktvendimi i dorëzohet palëve ndërgjyqësore, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave-Thesarit në Prishtinë, ndërsa një ekzemplar mbetet në lëndë.

## **A r s y e t i m**

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, më datë 19.04.2023, ka parashtruar propozim për përmbarrim kundër debitorit, lidhur me pagesën në emër të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, në bazë të aktgjykimit C.nr.763/2020 të datës 18.06.2021 dhe aktgjykimit të gjykatës së Apelit Ac.nr.6537/21 të datës 20.02.2023 dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarrimore, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej **3,167.44 euro**.

Pasi që aktvendimi mbi caktimin e përmbarrimit lëndor është bërë i formës së prerë nga data 31.08.2023 në kuptim të nenit 152 të LPP-së, si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L-48 (LMFPP) janë plotësuar kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e trajtuar aktvendimin në pikën I të dispozitivit si aktvendim me të cilin është caktuar ekzekutimi i kredisë në shumën monetare lëndore të debitorit në fjalë dhe kalimin e saj për arkëtimin në dobi të kreditorit në fjalë.

Sa i përket shpenzimeve në emër të procedurës kontestimore shumën prej 270€, përmbarrimore, dhe atë për përpilimin e propozimit shumën prej 156.00 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore për këtë propozim shumën prej 40 euro, gjykata në bazë të nenit 13.4 të LPP-së, ka vendosur që edhe këto shpenzime të procedurës të bien mbi barrën e debitorit, pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur detyrimet e parapara me dokumentin përmbarrues lëndor, si dhe kreditori nuk ka dhënë shkas në krijimit e shpenzimeve të procedurës përmbarrimore.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, pasi në nenin 14, paragraf 2 të LPP-së, lidhur me nenet 143 deri 156 nga Kreu IV i po këtij ligji nuk është paraparë paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me të cilin urdhërohet banka ose ndonjë institucion tjetër përkatës, siç kemi të bëjmë me rastin konkret si në dispozitiv të këtij aktvendimi të bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPP-së, përkitazi me përmbarrimin për kredinë sipas llogarisë në bankë. Arkëtimi lëndor i kredisë në të holla nga ana e subjekteve të caktuara siç kemi të bëjmë me rastin konkret, është rregulluar me nenin 40 të LMFPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**CP.nr. 264/2023, më datë 06.09.2023**

**Kryetari i Gjykatës,**  
**Venhar Salihu**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.